

INVESTITORI
Esha Materials L.L.C.
Hani i Elezit



RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)

**EKSPLOATIMI I GURIT GËLQEROR NË MIHJEN
SIPËRFAQËSORE “SEÇISHTË”**

Seçishtë, Komuna e Hanit të Elezit,

Shkurt 2026

Përmbajtja:

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)	1
1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	5
1.1 Të dhënat për aplikuesin	5
1.2 Të dhënat kryesore për projektin	5
1.3 Të dhënat për hartuesit e Raportit	5
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR	6
2.1 Kategoria e projektit	6
2.2 Përshkrimi i punëve përgatitore dhe ndërtimore	6
2.3 Karakteristikat kryesore të funksionimit	8
2.4 Përshkrimi i procesit teknologjik dhe funksionimit	10
2.5 Nevojat për resurse	12
2.6 Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve	13
2.7 Teknologjia e trajtimit të mbetjeve	15
2.8 Programi kohor dhe infrastruktura	16
2.9 Lidhjet me projekte të tjera	17
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR	19
3.1 Identifikimi dhe topografia	19
3.2 Distancat nga vendbanimet dhe objektet tjera	20
3.3 Karakteristikat fizike të terrenit	22
3.4 Karakteristikat klimatike	23
3.5 Biodiversiteti dhe peizazhi	24
3.6 Trashëgimia kulturore	25
3.7 Demografia dhe karakteristikat socio-ekonomike	26
4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISORË	27
4.1 Analiza e cilësisë aktuale të ajrit (gjendja zero)	27
4.2 Cilësia aktuale e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në lokacion	27
4.3 Niveli ekzistues i zhurmës në sfond	28
4.4 Gjendja e tokës	29
5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	30
5.1 Alternativa e zgjedhur (Lokacioni dhe teknologjia aktuale)	30
5.2 Arsyetimi i zgjedhjes	30

5.3 Alternativa "Zero" (Mos-veprimi)	31
6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS.....	33
6.1 Ndikimi në ajër	33
6.2 Ndikimi në ujë.....	34
6.3 Ndikimi në tokë.....	35
6.4 Zhurma dhe vibrimet.....	36
6.5 Biodiversiteti.....	36
6.6 Ndikimi socio-ekonomik	37
6.7 Peizazhi dhe trashëgimia.....	38
6.8 Ndikimet kumulative	39
6.9 Ndikimet ndërkufitare	39
7. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE REDUKTIMIN E NDIKIMEVE.....	40
7.1 Masat për mbrojtjen e ajrit.....	40
7.2 Masat për mbrojtjen e ujërave dhe tokës	40
7.3 Masat kundër zhurmës	41
7.4 Masat kundër zjarrit dhe emergjencave	41
7.5 Rehabilitimi (pas mbylljes së aktivitetit)	42
8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	43
8.1 Monitorimi i cilësisë së ajrit (Pluhuri)	43
8.2 Monitorimi i zhurmës dhe dridhjeve.....	43
8.3 Monitorimi i ujërave dhe sistemeve trajtuese	43
8.4 Monitorimi i rikultivimit dhe rehabilitimit	44
8.5 Raportimi	44
9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR (PMM).....	45
10. INFORMACIONE SHITESË, KARAKTERISTIKAT DHE BURIMET E TË DHËNAVE.....	47
10.1 Baza ligjore dhe rregullative.....	47
10.2 Dokumentacioni teknik i projektit	48
10.3 Të dhënat mjedisore dhe shkencore.....	48
10.4 Karakteristikat specifike	49
11. BURIMET E TË DHËNAVE DHE LITERATURA	50
12. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT.....	52

12.1 Hyrje	52
12.2 Përshkrimi i projektit	52
12.3 Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse	52
12.4 Përfitimet socio-ekonomike	53
12.5 Përfundim.....	53
SHTOJCAT	54
LISTA E FIGURAVE:	54

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1.1 Të dhënat për aplikuesin

- **Investitori:** “Esha Materials” SH.P.K.
- **Përfaqësuesi i autorizuar/Pronari:** Golden Consulting Centre SH.P.K.
- **Selia e biznesit:** Rruga “Adem Jashari”, Nr. 280, Hani i Elezit, Republika e Kosovës.
- **Numri unik identifikues (ARBK):** 810847618.
- **Numri fiskal:** (Sipas certifikatës së biznesit në shtojcë).
- **Të dhënat e kontaktit:**
 - E-mail: Zenulla.Burniku@sharrcem.com, Dardan.Dernjani@sharrcem.com, ibushluzha@hotmail.com
 - Telefon: +383 49 757 309; +383 49 757433; +383 44 124 889

1.2 Të dhënat kryesore për projektin

- **Titulli zyrtar i projektit:** Eksploatimi i Gurit Gëlqeror në lokalitetin Seçishtë.
- **Lloji i aktivitetit:** Industri nxjerrëse (Minierë/Gurore sipërfaqësore).
- **Vendndodhja e projektit:** Fshati Seçishtë, Komuna e Hanit të Elezit.
- **Numrat i parcelës kadastrale:** P-73317079-01116-0, Zona Kadastrale Seçishtë.
- **Vlera totale e investimit:** 464,500.00 € (Katërqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e pesëqind euro dhe zero cent)
- **Pozita gjeografike:** Zona kufizohet në veri me fshatin Seçishtë dhe në jug me kufirin e Maqedonisë së Veriut.

1.3 Të dhënat për hartuesit e Raportit

- **Hartuesi i raportit:** Ibush Luzha.
- **Kualifikimi:** Doktor i Shkencave të Gjeologjisë dhe Minierave; Ekspert i licencuar për VNM.
- **Numri i Licencës:** 84/18 (Lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 27.05.2022, vlefshmëria deri më 26.05.2027).
- **Kontakti i hartuesit:** ibushluzha@hotmail.com, Tel: 044 124 889.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1 Kategoria e projektit

Projekti i propozuar nga ndërmarrja “Esha Materials” SH.P.K. klasifikohet zyrtarisht në kategorinë e aktiviteteve industriale nxjerrëse, konkretisht për eksploatimin dhe përpunimin e materialeve minerale jometalike (guri gëlqeror). Ky aktivitet parashihet të realizohet përmes metodës së mihjes sipërfaqësore në lokalitetin e Seçishtës, duke përdorur teknologji bashkëkohore për shpimin, minimin dhe transportin e lëndës së parë.

Në aspektin ligjor, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, ky projekt bën pjesë në listën e aktiviteteve që kërkojnë vlerësim të detajuar mjedisor. Nevoja për procedurën e plotë të VNM-së vjen si rrjedhojë e dy faktorëve kyç:

Sipërfaqja e operimit: Projekti përfshin një hapësirë prej 73,035 m² (mbi 7.3 hektarë), e cila i kalon pragjet teknike për procedurat e thjeshtuara mjedisore.

Natyra e punimeve: Përdorimi i lëndëve plasëse (minimit), ndryshimi i morfologjisë së terrenit dhe vëllimi i lartë i nxjerrjes së gurit gëlqeror, kërkojnë një analizë të hollësishme për të parandaluar ndotjen e ajrit, zhurmën dhe dridhjet sizmike në rrethinë.

Ky projekt ka një rëndësi strategjike për ekonominë lokale dhe rajonale, pasi synon furnizimin e vazhdueshëm me lëndë të parë cilësore për industrinë e ndërtimit dhe, në mënyrë specifike, për industrinë e prodhimit të çimentos në Han të Elezit. Përmes kësaj VNM-je, sigurohet që të gjitha fazat e eksploatimit të jenë në përputhje të plotë me standardet mjedisore të Republikës së Kosovës dhe direktivat e Bashkimit Evropian, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm që balancon interesin ekonomik me mbrojtjen e ekosistemit dhe shëndetin e popullatës në fshatin Seçishtë.

2.2 Përshkrimi i punëve përgatitore dhe ndërtimore

Përpara fillimit të procesit teknologjik të eksploatimit të gurit gëlqeror në lokalitetin “Seçishtë”, ndërmarrja parashikon një fazë intensive të punëve përgatitore. Kjo fazë është kryesore për të siguruar një operim të rregullt, mbrojtjen e shtresave organike të tokës dhe krijimin e kushteve të sigurisë në punë. Aktivitetet fillestare janë të ndara në tri shtylla kryesore:

Pastrimi i terrenit dhe menaxhimi i vegjetacionit

Hapi i parë konsiston në pastrimin e plotë të sipërfaqes operationale prej 73,035 m². Bazuar në vëzhgimet në terren, kjo zonë karakterizohet nga një bimësi e ulët barishtore, kaçuba dhe shkurre tipike për malet e klasit të 5-të. Ky proces përfshin largimin mekanik të mbetjeve bimore pa përdorur metoda djegieje, për të shmangur emetimet e panevojshme në ajër. Materiali drunor i imët dhe shkurret do të largohen në mënyrë të organizuar, duke hapur rrugë për makineritë e rënda gjermuese. Ky pastrim bëhet në mënyrë graduale, vetëm në zonat ku planifikohet hapja e fronteve të para të punës, për të minimizuar ekspozimin e panevojshëm të tokës ndaj erozionit.

Largimi selektiv i sterilit dhe ruajtja e shtresës humusore

Një ndër proceset më të rëndësishme mjedisore është heqja e sterilit (dheut pa vlerë minerale) dhe shtresës aktive organike. Trashësia e kësaj shtrese në zonën e Seçishtës varion nga 0.25m deri në 0.50m.

- Vlera e materialit: Ky dheu humusor konsiderohet si resurs i vlefshëm për fazën finale të projektit.
- Metoda e deponimit: Dheu do të gjermohet dhe do të transportohet në deponi të caktuara brenda perimetrit të projektit, ku do të paloset në pìrgje të mbrojtura.
- Objektivi: Deponimi i tij bëhet në atë mënyrë që të parandalohet kalbja apo shpëlarja nga ujërat atmosferikë. Ky material do të shërbejë ekskluzivisht si substrat për rikultivimin biologjik pas përfundimit të ciklit të nxjerrjes, duke mundësuar kthimin e zonës në gjendje të gjelbëruar (pyllëzimin me pisha).

Ndërtimi i infrastrukturës teknike dhe rrugëve

Për të mundësuar lëvizjen e pajisjeve të rënda si ekskavatorët, buldozerët dhe kamionët transportues, do të realizohen ndërhyrje infrastrukturore:

- Rrugët: Do të bëhet zgjerimi dhe stabilizimi i rrugës ekzistuese që lidh lokacionin me rrugën magjistrale Prishtinë–Shkup (distancë rreth 3000m). Rrugët do të nivelohen për të përballuar peshat e rënda dhe për të minimizuar pluhurin sekondar gjatë qarkullimit.

- Sheshet e punës dhe platformat: Do të krijohen platforma manipulative (sheshet e shkallëve) me gjerësi 10-15 metra, të cilat shërbejnë si baza për vendosjen e garniturave shpuese dhe manovrimin e kamionëve gjatë ngarkimit.
- Drenazhimi fillestar: Gjatë ndërtimit të rrugëve, do të hapen kanale anësore për menaxhimin e ujërave të reshjeve, duke parandaluar vërshimet lokale në frontet e punës dhe duke mbrojtur strukturën e rrugëve prej degradimit.

Të gjitha këto punë përgatitore do të kryhen nën mbikëqyrjen e inxhinierëve duke respektuar distancat e sigurisë nga zonat e banuara dhe kufiri shtetëror.

2.3 Karakteristikat kryesore të funksionimit

Për realizimin e projektit të eksploatimit në lokalitetin “Seçishtë”, është përzgjedhur metoda e mihjes sipërfaqësore me sistem etazhesh (shkallësh) zbritëse. Kjo metodologji është përzgjedhur si më e sigurt dhe më efiçientja për konfiguracionin kodrinor-malor të terrenit dhe vetitë fiziko-mekanike të gurit gëlqeror në këtë zonë. Parametrat kryesorë gjeometrikë të mihjes janë projektuar si vijon:

a. Struktura dhe numri i shkallëve (Etazheve)

Projekti parashikon zhvillimin e mihjes përmes 10 shkallëve teknologjike. Operimi do të fillojë nga kuota më e lartë topografike e vendburimit (rreth 795m lartësi mbidetare) dhe do të zbresë gradualisht deri në kuotën përfundimtare të projektuar (rreth 690m). Ky sistem prej 10 nivelesh lejon një kontroll më të mirë të stabilitetit të masivit shkëmbor dhe mundëson që proceset e shpimit dhe minimit të kryhen në mënyrë të kontrolluar, duke mos ndërprerë asnjëherë procesin e transportit të lëndës së parë.




Figura 1: Harta e situacionit ku do të eksploatohet guri gëlqeror

b. Lartësia e projektuar e shkallës

Lartësia teknike e çdo shkalle është përcaktuar të jetë 10 metra. Ky dimension është llogaritur duke u bazuar në dy faktorë kyç:

- Kapaciteti i makinerive: Kjo lartësi përputhet plotësisht me rrezën e punës së ekskavatorëve dhe garniturave shpuese që do të përdoren, duke siguruar që mjetet të kenë qasje të plotë në të gjithë profilin e shkallës.
- Siguria: Një lartësi prej 10 metrash minimizon rrezikun e rënieve masive të gurëve të pakontrolluar pas minimumit, duke e bërë më të lehtë procesin e "pastrimit" (rregullimit) të faqeve të shkallës nga punëtorët dhe makineritë.

c. Gjerësia e shesheve të punës (Platformave)

Gjerësia e platformave operative (shesheve) do të variojë nga 10 deri në 15 metra. Kjo hapësirë është e mjaftueshme për të garantuar:

- Manovrimin e mjeteve: Lejon qarkullimin e lirshëm të kamionëve të rëndë transportues dhe pozicionimin e sigurt të lopatave ngarkuese (ekskavatorëve).
- Zonën e sigurisë: Ofron një distancë mbrojtëse ndërmjet buzës së shkallës dhe zonës ku kryhet ngarkimi, duke parandaluar aksidentet teknike.
- Menaxhimin e materialit: Sheshet shërbejnë si hapësira për depozitimin e përkohshëm të masës së thyer pas minimumit, përpara se ajo të transportohet drejt gurthyesisit.

d. Pjerrtësia e faqes së shkallës

Këndi i pjerrtësisë punuese të shkallës është projektuar në 70 gradë. Ky parametër është përcaktuar duke marrë parasysh stabilitetin gjeoteknik të gurit gëlqeror të Seçishtës, i cili njihet si një shkëmb masiv dhe me qëndrueshmëri të lartë.

- Këndi prej 70 gradësh siguron një ekuilibër optimal midis nxjerrjes maksimale të vëllimit të gurit dhe parandalimit të rrëshqitjeve të mundshme.
- Gjatë fazës së mbylljes dhe rikultivimit, këto shkallë do të nivelohen dhe do të mbulohen me steril për të krijuar një pjerrtësi më të butë (përfundimtare), e cila do të mundësojë pyllëzimin e suksesshëm të zonës.

Ky strukturim gjeometrik siguron që procesi i eksplotimit të jetë sistematik, i monitorueshëm në çdo fazë dhe me ndikim minimal vizual në peizazhin rrethues.

2.4 Përshkrimi i procesit teknologjik dhe funksionimit

Procesi teknologjik i eksplotimit të gurit gëlqeror në mihjen sipërfaqësore “Seçishtë” është i organizuar si një cikël i mbyllur dhe i mirëfilltë industrial, ku çdo fazë është e koordinuar për të garantuar efikasitet maksimal dhe ndikim minimal në mjedisin rrethues dhe kapaciteti do të sillet rreth 150-200 m³/orë. Ky proces ndjek tri fazat kryesore teknike:

a. Procesi i shpimit dhe përgatitja e fushës minuese

Ky është hapi i parë operativ që përcakton ecurinë e eksploatimit. Shpimi i vrimave vertikale dhe të pjerrëta do të kryhet me garnitura shpuese moderne, të cilat janë të projektuara për të operuar në masivë shkëmborë të fortë.

- **Mbrojtja e ajrit:** Çdo njësi shpuese është e pajisur me sistemin integral të thithësve të pluhurit. Tubi i thithësit vendoset direkt në grykën e vrimës që shpohet, duke kapur grimcat e imëta (PM10) përpara se ato të emetohen në atmosferë. Pluhuri i grumbulluar trajtohet si mbetje teknologjike e thatë dhe asgjësohet sipas rregullave mjedisore.
- **Parametrat:** Vrimat shpohen sipas një rrjeti të paracaktuar gjeometrik, i cili mundëson thyerjen e shkëmbit në granulometrinë e dëshiruar, duke minimizuar nevojën për thyerje dytësore.

b. Minimi i kontrolluar dhe menaxhimi i eksplozivëve

Pas përgatitjes së vrimave, bëhet mbushja e tyre me lëndë plasëse të tipit Amonal i përforcuar, i cili njihet për efikasitetin e tij të lartë në shkëmbinj të gëlqerorë.

- **Siguria sizmike:** Për të mbrojtur objektet e banimit (fshatin Seçishtë) dhe strukturat tjera, do të aplikohet minimi me vonesë milisekondëshe. Sasia e eksplozivit është e limituar në 30 kg për vrimë, sasi kjo që është 36 herë më e vogël se kufiri i lejuar për distancën prej 800 metrash. Shpejtësia e oscilimeve sizmike do të mbahet nën nivelin kritik prej 0.4 - 0.8 cm/s, duke garantuar që dridhjet të mos ndihen nga popullata.
- **Zona e rrezikut:** Gjatë minimumit, vendosen roje në kufijtë e zonës së sigurisë prej 250 metra (rrezja e hedhjes së gurëve), duke siguruar që asnjë person apo mjet të mos jetë i pranishëm brenda kësaj zone. Minimet do të kryhen vetëm gjatë ditës dhe në kushte atmosferike pa erëra të forta.

c. Ngarkimi, transporti dhe furnizimi i njësisë thërrmuese

Masa shkëmbore e thyer pas minimumit i nënshtrohet procesit të logjistikës së brendshme minerare:

- **Mekanizimi:** Përdoren ekskavatorë me fuqi të lartë dhe lopata ngarkuese për grumbullimin e gurit. Transporti realizohet me 2 deri në 3 kamionë specialë (damperë) të tonazhit të rëndë.

- Menaxhimi i pluhurit dhe rrugëve: Gjatë lëvizjes së kamionëve drejt njësisë së thërrmimit (gurthyesit me seperacion), sipërfaqet e rrugëve dhe sheshet do të spërkatën vazhdimisht me ujë përmes cisternave mobile. Ky veprim parandalon ngritjen e pluhurit sekondar.
- Granulometria: Mjetet ngarkuese sigurojnë që në procesin e thërrmimit të mos kalojnë blloqe më të mëdha se 20% e kapacitetit të fytit pranues të gurthyesit, duke rritur efikasitetin e prodhimit të fraksioneve për industrinë e çimentos.

Ky proces teknologjik siguron një prodhim të qëndrueshëm, duke respektuar në çdo hap sigurinë teknike dhe mbrojtjen e faktorëve mjedisorë në lokacionin Seçishtë.

2.5 Nevojat për resurse

Për të garantuar mbarëvajtjen e procesit të eksploatimit në lokalitetin “Seçishtë” dhe për të implementuar masat mbrojtëse mjedisore, ndërmarrja “Esha Materials” do të shfrytëzojë resurset e mëposhtme, të ndara sipas kategorive:

a. Energjia dhe karburantet

Fuqia lëvizëse e projektit bazohet kryesisht në energjinë e përfituar nga djegia e brendshme dhe ajo elektrike autonome.

- Karburanti (Diesel): Makineritë e rënda (ekskavatori, buldozeri, kamionët damperë) prej rreth 500-800 litra në muaj dhe garnitura shpuesë furnizohen me naftë të standard të lartë për të minimizuar emetimin e gazeve ndotëse. Transporti i naftës bëhet përmes autocisternave të licencuara, ndërsa furnizimi i mjeteve kryhet në platforma të sigurta për të parandaluar rrjedhjet në tokë.
- Energjia elektrike: Për nevojat e ndriçimit të zonës operacionale, pultit komandues dhe zyrave administrative mobile, do të përdoret një gjenerator elektrik (p.sh. 50-100 KW) si burim primar, me mundësi lidhjeje në rrjetin publik të KEDS-it në fazat e mëvonshme të zhvillimit të infrastrukturës.

b. Resurset ujore (Menaxhimi i pluhurit dhe nevojat sanitare):

Uji është resurs esencial, veçanërisht për reduktimin e ndikimeve mjedisore në ajër.

- Uji teknologjik: Do të përdoret ekskluzivisht për spërkatjen e rrugëve deri në minierë (3000m rrugë të paasfaltuara) rreth 10 m³ dhe shesheve të punës për të parandaluar

ngritjen e pluhurit sekondar. Furnizimi sigurohet përmes cisternave mobile me ujë (kapaciteti rreth 10-15 m³), të cilat do të jenë në disponim të vazhdueshëm në lokacion.

- Uji sanitar: Për nevojat higjienike të personelit, furnizimi do të bëhet me ujë të pijshëm të ambalazhuar dhe ujë teknik nga rezervuarët e lëvizshëm, duke u siguruar që asnjë shkarkim të mos bëhet në natyrë pa trajtim paraprak në gropën septike.

c. Materialet minerare dhe ndihmëse

Realizimi i operacioneve kërkon materiale specifike me rrezikshmëri të lartë, të cilat menaxhohen sipas protokolleve strikte:

- Lëndët plasëse (Eksplozivët): Përdoret Amonal i përforcuar dhe kapsolla detonuese. Këto materiale nuk do të ruhen në lokacion (përveç nëse ndërtohet depo e certifikuar), por do të sillen nga furnitorët e licencuar vetëm në ditën e minimumit dhe do të përdoren menjëherë nën mbikëqyrjen e personave të certifikuar.
- Lubrifikantët dhe vajrat: Për mirëmbajtjen teknike të makinerive (ndërrimi i vajrave, yndyrave hidraulike) do të përdoren produkte të shoqëruara me Fletë-të-dhënat e Sigurisë (MSDS). Të gjitha mbetjet e këtyre materialeve (vajrat e përdorur) do të grumbullohen në fuçi të mbyllura hermetikisht dhe do të ruhen në depo të përkohshme me dysheme të izoluar (beton) deri në dorëzimin tek operatorët e licencuar për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme.

Ky plan i menaxhimit të resurseve siguron që operimi të jetë efikas dhe të minimizojë çdo rrezik për ndotjen e tokës apo të ujërave nëntokësore në komunën e Hanit të Elezit.

2.6 Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve

Gjatë realizimit të aktiviteteve minerare në mihjen sipërfaqësore “Seçishtë”, operimi i makinerive të rënda, përdorimi i lëndëve plasëse dhe proceset logjistike rezultojnë në gjenerimin e mbeturinave dhe emetimeve të ndryshme. Këto ndikime analizohen në aspektin cilësor dhe sasior për të siguruar që operimi i ndërmarrjes “Esha Materials” të mbetet brenda kufijve të lejuar ligjorë.

a. Emetimet në ajër (Pluhuri dhe gazrat)

Emetimi kryesor në mjedis gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror është pluhuri (grimcat e suspenduara PM10 dhe PM2.5). Ky emetim ndodh në tri pika kyçe:

Gjatë shpimit: Garniturat shpuese gjenerojnë pluhur të imët teknologjik. Për të parandaluar shpërndarjen, ndërmarra përdor thithës pluhuri me thasë filtrues.

Gjatë minimit: Shpërthimi i lëndëve plasëse krijon emetim momental të pluhurit dhe gazeve (CO, NOx). Ky ndikim është i përkohshëm dhe lokalizohet brenda rrezes së sigurisë.

Transporti dhe rrugët: Lëvizja e kamionëve në rrugët e paasfaltuara (3000m) është burimi kryesor i pluhurit sekondar. Masat parandaluese përfshijnë spërkatjen e rregullt të rrugëve me ujë dhe mbulimin e ngarkesave me mushama.

Sa i përket gazeve shkarkuese nga motorët e makinerive, emetimet e CO₂ dhe NOx vlerësohen si të ulëta dhe lehtësisht të absorbueshme nga vegjetacioni rrethues, për shkak të hapësirës së hapur dhe qarkullimit të rrymave të ajrit në grykën e Seçishtës.

b. Shkarkimet në ujë

Procesi i eksploatimit të gurit gëlqeror në këtë lokalitet është një proces "i thatë", që do të thotë se nuk gjenerohen ujëra të ndotura industriale nga procesi i nxjerrjes. Megjithatë, rreziqet lidhen me:

- Ujërat atmosferike: Gjatë reshjeve, uji i shiut që bie në platformat operative mund të bartë pluhur ose sedimente drejt lumit Lepenc. Për këtë qëllim, janë projektuar pusët sedimentuese (fundërruesit) për pastrimin e ujit para shkarkimit.
- Rrjedhjet aksidentale: Ekziston rreziku i rrjedhjes së naftës apo vajrave hidraulikë nga makineritë. Ky rrezik adresohet përmes separatorëve vaj-ujë dhe zonave të izoluara për parkim.

c. Gjenerimi i mbeturinave të ngurta

Mbeturinat e ngurta ndahen në tri kategori kryesore:

Mbeturinat minerare (Sterili): Përbëhen nga shtresa humusore dhe dheu pa vlerë minerale (trashësia 0.25m - 0.50m). Ky material gjenerohet në vëllime të mëdha por nuk trajtohet si mbeturinë për asgjësim, por si resurs për rikultivimin e ardhshëm të shkallëve të mihjes.

Mbeturinat industriale (Jo të rrezikshme): Përfshijnë pjesë metalike të dëmtuara (skrap), goma të konsumuara të makinerive dhe ambalazhe të ndryshme. Këto do të grumbullohen në pika të caktuara dhe do të dorëzohen te kompanitë e licencuara për riciklim.

Mbeturinat komunale: Gjenerohen nga aktivitetet e përditshme të personelit (ushqim, letër, plastikë). Këto do të menaxhohen përmes kontejnerëve standardë dhe do të largohen nga

kompania rajonale e mbeturinave. Më poshtë po paraqesim mbeturinat sipas: Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave.

Lloji i mbeturinës	Kodi i mbeturinave
Vajrat e përdorura	13 02 05*
Gomat e vjetra	16 01 03
Bateritë e vjetra	16 06 01*
Mbeturinat inerte	17 05 04

d. Zhurma dhe vibrimet

Zhurma gjenerohet nga motorët e makinerive dhe thërrmimi i gurit. Nivelet e matur prej 90 dB te burimi reduktohen në mënyrë natyrale me distancën, duke arritur në rreth 25 dB në distancën prej 500 metrash, gjë që nuk paraqet shqetësim për banorët e fshatit Seçishtë (të cilët ndodhen mbi 800m larg). Vibrimet sizmike nga minimi kontrollohen përmes sasisë së kufizuar të eksplozivit (30kg/vrimë), duke mbajtur shpejtësinë e oscilimit nën limitet kritike për stabilitetin e objekteve rrethuese.

Përmes zbatimit të Planit të Menaxhimit Mjedisor, të gjitha këto emetime do të monitorohen periodikisht për të garantuar mbrojtjen e ekosistemit lokal.

2.7 Teknologjia e trajtimit të mbetjeve

Ndërmarrja “Esha Materials” aplikon një sistem të integruar të trajtimit të mbeturinave dhe emetimeve, i cili bazohet në parimin e parandalimit në burim dhe riciklimit të materialeve inerte brenda lokacionit. Teknologjia e trajtimit është e specifikuar sipas kategorive të mbetjeve:

a. Trajtimi i pluhurit teknologjik dhe sekondar

Për kapjen e pluhurit gjatë shpimit, përdoret teknologjia e thithësve integralë me thasë filtrues që parandalojnë emetimin e PM10 në atmosferë. Për pluhurin sekondar në rrugët qasëse (3000m), aplikohet teknologjia e spërkatjes me ujë përmes cisternave me presion të ulët. Ky proces realizon "rëndimin" e grimcave të pluhurit, duke i detyruar ato të sedimentojnë në tokë dhe duke parandaluar transportin e tyre nga era drejt zonave të banuara.

b. Trajtimi i mbetjeve minerale (Sterili dhe humusi)

Teknologjia e trajtimit të sterilit bazohet në "deponimin selektiv". Shtresa humusore (0.25m - 0.50m) trajtohet si resurs biologjik; ajo gërmohet veçmas dhe deponohet në pìrgje të mbrojtura nga erozioni dhe shpëlarja. Ky material nuk asgjësohet, por trajtohet si substrat aktiv që do të

përdoret për rikultivimin biologjik (pyllëzimin) e shkallëve të mihjes pas përfundimit të eksploatimit.

c. Sistemi i trajtimit të ujërave (Fiziko-mekanik)

Ujërat e reshjeve që rrjedhin nga platformat operative trajtohen përmes një sistemi kaskadë të puseve sedimentuese (fundërruesve). Kjo teknologji lejon fundërrimin e grimcave të ngurta (rërës dhe baltës) para se uji të infiltrohet në tokë. Në zonat e parkimit të makinerive, instalohet një separator i vajrave dhe yndyrnave që ndan derivatet e naftës nga uji përmes parimit të densitetit. Ujërat sanitare trajtohen në një gropë septike hermetike, duke parandaluar ndotjen e ujërave nëntokësore.

d. Mbetjet e rrezikshme

Vajrat e përdorur grumbullohen në fuçi metalike , të vendosura mbi vaska mbrojtëse (beton/plastikë) për të parandaluar rrjedhjet aksidentale, deri në dorëzimin te operatorët e licencuar për asgjësim final.




Figura 2: Skema teknologjike e trajtimit të ujërave

2.8 Programi kohor dhe infrastruktura

Realizimi i projektit të eksploatimit të gurit gëlqeror në Seçishtë ndjek një plan dinamik, i cili integron fazat e përgatitjes, operimit intensiv dhe mbylljes me rehabilitim. Programi është

hartuar për të siguruar furnizim të qëndrueshëm të industrisë së çimentos, duke respektuar kufizimet kohore mjedisore.

a. Dinamika e zbatimit dhe jetëgjatësia

- Faza përgatitore: Parashihet të zgjasë rreth 3 deri në 6 muaj, periudhë gjatë së cilës do të bëhet pastrimi i terrenit, largimi i shtresës humusore (0.25m – 0.50m) dhe stabilizimi i rrugës qasëse.
- Faza e operimit (Eksplotimit): Duke u bazuar në sipërfaqen prej 7.3 hektarësh dhe rezervat e konstatuara gjeologjike, jetëgjatësia e projektit llogaritet të jetë afatgjatë (mbi 15-20 vite), në varësi të dinamikës së nxjerrjes dhe kërkesës së tregut.
- Orari i punës: Për të minimizuar shqetësimin për banorët e fshatit Seçishtë, aktivitetet kryesore (shpimi dhe thërrmimi) do të zhvillohen në një ndërresë ditore (07:00 – 16:00). Procesi i minimumit do të kryhet vetëm në termine të caktuara kohore, në mesditë, kur kushtet atmosferike janë të favorshme (pa erëra të forta).

b. Infrastruktura ekzistuese dhe e propozuar

- Qasja rrugore: Lokacioni lidhet me rrugën magjistrale Prishtinë – Shkup përmes një rruge të paasfaltuar me gjatësi rreth 3000 metra. Kjo rrugë do të mirëmbahet dhe do të zgjerohet për të përballuar qarkullimin e kamionëve të rëndë.
- Energjia dhe ujësjellësi: Për shkak të natyrës rurale të lokacionit, infrastruktura energjetike do të bazohet në gjeneratorë autonomë (50-100 KW) për nevojat e garniturës shpuese dhe ndriçimit. Furnizimi me ujë teknologjik sigurohet përmes cisternave mobile të ndërmarrjes, të cilat do të shërbejnë ekskluzivisht për spërkatjen e rrugëve dhe shesheve.
- Objektet ndihmëse: Brenda perimetrit të projektit do të vendosen kontejnerë modularë për zyrat administrative, hapësirat e pushimit për punëtorët, nyja sanitare e lidhura me gropën septike, dhe një depo të përkohshme të izoluar për vajrat e përdorur.

Ky program siguron që operimi të jetë sistematik dhe që infrastruktura të jetë në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë në punë.

2.9 Lidhjet me projekte të tjera

Projekti i eksplotimit të gurit gëlqeror në Seçishtë ka një lidhje të drejtpërdrejtë teknologjike dhe ekonomike me industrinë e rëndë në rajon. Lidhja parësore strategjike është me fabrikën e

prodhimin të çimentos në Han të Elezit, për të cilën ky projekt shërben si burim stabil i lëndës së parë minerale. Ky ndërvarësi mundëson një zinxhir prodhimi lokal efikas, duke reduktuar ndjeshëm nevojën për import të lëndës së parë dhe kostot e transportit.

Në aspektin e infrastrukturës, projekti ndërlidhet me rrjetin rrugor kombëtar përmes rrugës magjistrale Prishtinë–Shkup, e cila shërben si arterie kryesore për shpërndarjen e fraksioneve të gurit drejt tregut të ndërtimit.

Gjithashtu, aktiviteti është në harmoni me Planet Zhvillimore Komunale, të cilat e përcaktojnë këtë zonë si rajon me potencial të lartë për industrinë nxjerrëse. Ndikimet kumulative (zhurma, pluhuri) analizohen në raport me guroret ekzistuese në zonë, duke siguruar që standardet mjedisore të mbeten brenda normave të lejuara për grykën e lumit Lepenc.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1 Identifikimi dhe topografia

Lokacioni i propozuar për eksploatimin e gurit gëlqeror nga ndërmarrja “Esha Materials” SH.P.K. ndodhet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës, konkretisht në fshatin Seçishtë, Komuna e Hanit të Elezit. Ky projekt shtrihet në pjesën e kodrës mbi fshatin Seçishtë, në vendin e quajtur “Kodra”, dhe është i identifikuar me parcelën kadastrale P-73317079-01116-0, me një sipërfaqe totale prej 73,035 m² (mbi 7.3 hektarë). Pozita gjeografike është strategjike, pasi ndodhet rreth 3 km në jug të qendrës komunale dhe kufizohet në jug me kufirin shtetëror të Maqedonisë së Veriut, në perëndim me Krivenikun dhe në lindje me Bllacën.

Nga aspekti morfologjik dhe topografik, terreni karakterizohet si një zonë tipike kodrinore-malore, pjesë e thyerjeve ndërmjet maleve të Sharrit në perëndim dhe Karadakut në lindje. Lartësia mbidetare e zonës operationale varion nga 690 metra (në kuotën më të ulët të shkallës përfundimtare) deri në 795 metra (në majë të vendburimit), duke krijuar një disnivel lartësie prej 105 metrash. Terreni prezantohet me shpate të pjerrëta dhe formacione shkëmbore të zhveshura, ku dominon lënda gëlqerore masive e cilësisë së lartë. Ky konfiguracion lejon zbatimin e sistemit të mihjes me shkallë zbritëse, duke shfrytëzuar rënien natyrale të terrenit për drenazhimin e ujërave atmosferikë drejt luginës së lumit Lepenc.




Figura 3: Harta topografike e lokacionit

3.2 Distancat nga vendbanimet dhe objektet tjera

Përcaktimi i distancave ndërmjet zonës operationale të mihjes dhe vendbanimeve njerëzore është një element kyç në vlerësimin e ndikimit mjedisor, veçanërisht për sa i përket sigurisë nga dridhjet sizmike, zhurmës dhe pluhurit. Bazuar në matjet e realizuara në terren dhe planet kadastrale, situata prezantohet si vijon:

- Shtëpitë dhe zonat e banuara: Objektet më të afërta të banimit (shtëpitë e fshatit Secishtë) ndodhen në një distancë prej mbi 800 metrash nga pjesët aktive të punës të gurores. Kjo hapësirë shërben si një brez tampon tejet i sigurt, i cili garanton që efektet e minimumit të mos kenë asnjë ndikim fizik në stabilitetin e strukturave të banimit. Sipas llogaritjeve teknike, në këtë distancë, niveli i zhurmës nga makineritë dhe thërrmimi bie nën normat e lejuara ditore, ndërsa shpejtësia e oscilimeve sizmike mbetet brenda kufijve që nuk ndihen nga popullata. Për më tepër, për shkak të konfigurimit të relievit, nuk parashihet asnjë nevojë për zhvendosje të popullatës apo shpronësime të objekteve të banimit.

- Lumi Lepenc dhe rrjeti hidrografik: Lumi Lepenc, i cili është arteria kryesore ujore e rajonit, rrjedh në afërsi të zonës së projektit (rreth 1 km distancë). Lokacioni i mihjes është pjesë integrale e pellgut ujëmbledhës të lumit Lepenc. Të gjitha ujërat atmosferike që do të drenazhohen nga sipërfaqja operationale prej 7.3 hektarësh do të ndjekin rënien natyrale të terrenit drejt luginës së këtij lumi. Për të parandaluar ndotjen e lumit nga sedimentet apo mbetjet inerte (rëra, balta), projekti parashikon sisteme fundërruese, duke siguruar që vetëm ujërat e pastra të derdhen në recipientin final.
- Infrastruktura rrugore dhe qasja: Lokacioni ndodhet rreth 3000 metra larg rrugës magjistrale Prishtinë – Shkup. Kjo distancë mundëson që transporti i lëndës së parë të bëhet pa ndikuar drejtpërdrejt në trafikun e brendshëm të fshatrave përreth. Rruga qasëse kalon nëpër zona të pabanuara (kodrina), duke minimizuar kështu ndikimin e pluhurit dhe zhurmës gjatë lëvizjes së kamionëve të rëndë.
- Kufiri shtetëror dhe zonat fqinje: Në anën jugore, projekti kufizohet me kufirin e Maqedonisë së Veriut, në perëndim me Krivenikun dhe në lindje me Bllacën. Operimet minerare janë planifikuar të mbeten strikt brenda perimetrit të parcelës, duke mos cenuar asnjë objekt apo infrastrukturë në zonat kufitare apo fshatrat fqinjë.



Figura 4: Distancën nga shtëpitë e fshatit Seçishtë

Ky pozicionim gjeografik konsiderohet ideal për industrinë nxjerrëse, pasi ofron izolim natyror nga zonat e dendura të banimit, duke mundësuar një aktivitet ekonomik pa konflikte sociale.

3.3 Karakteristikat fizike të terrenit

Karakteristikat fizike të lokacionit Seçishtë luajnë një rol përcaktues në qëndrueshmërinë e mjedisit dhe sigurinë e operimeve teknologjike. Analiza e detajuar e terrenit përfshin këto shtylla kryesore:

- **Ndërtimi gjeologjik dhe përbërja litologjike**

Zona e projektit shtrihet mbi një formacion masiv të sedimenteve të kretakut të sipërm (K_2^{2-3}) i cili karakterizohet nga prania e gurëve gëlqerorë cilësorë me shtrirje të gjatë (600-800 metra) dhe gjerësi deri në 150 metra. Këta gëlqerorë janë kryesisht masivë, me ngjyrë hiri në të bardhë, dhe njihen për pastërtinë e tyre të lartë kimike (përmbajtje e lartë e $CaCO_3$). Ky profil gjeologjik e bën lëndën e parë tejet të përshtatshme për industrinë e rëndë të ndërtimit, veçanërisht për prodhimin e çimentos, ku kërkohet qëndrueshmëri dhe homogjenitet i materialit. Përveç gëlqerorit, në rrethinë hasen edhe rreshe kristalore dhe formacione flishore, të cilat sigurojnë një bazament stabil për zhvillimin e mihjes.

- **Gjeomorfologjia dhe stabiliteti i terrenit**

Relievi është tipik kodrinor-malor, me shpate që kanë një rënie natyrale drejt luginës së lumit Lepenc. Për shkak të natyrës shkëmbore të masivit, rreziku nga erozioni masiv apo rrëshqitjet e dheut është minimal. Masivi gëlqeror është i fortë dhe i aftë të mbajë faqe të shkallëve me pjerrtësi deri në 70 gradë pa cenuar stabilitetin gjeomekanik. Megjithatë, gjatë operimit, çdo shkallë do të pastrohet nga blloqet e lëkundura pas minimumit për të parandaluar rënien aksidentale të gurëve.

- **Sizmika dhe analiza e dridhjeve tekniko-teknologjike**

Rajoni i Hanit të Elezit bën pjesë në zonat me aktivitet sizmik të njohur, por ndikimi i operimeve minerare (minimit) është llogaritur me saktësi për të eliminuar çdo rrezik mjedisor apo strukturor. Territori i komunës bën pjesë në Zonën e V-të të goditjes sizmike, me intensitete që arrijnë deri në 7–8 gradë sipas shkallës MSC

Shpejtësia e lëkundjeve: Planet e minimin janë projektuar në atë mënyrë që shpejtësia e oscilimeve të trupit të mos tejkalojë kufirin prej 0.4 deri në 0.8 cm/s. Ky nivel është i barabartë me shkallën e tretë të Merkalit, e cila konsiderohet plotësisht e padëmshme për objektet e banimit që ndodhen mbi 800 metra larg.

Konsumi i eksplozivit: Për të siguruar këto parametra, konsumi i eksplozivit është i kufizuar në 30 kg për vrimë, sasi kjo që është 36 herë më e vogël se limiti teorik i lejuar për distancat

ekzistuese. Përdorimi i kapsollave me vonesë milisekondëshe mundëson që energjia e shpërthimit të shpërndahet në kohë, duke reduktuar valën goditëse në tokë dhe zhurmën akustike në ajër.

Kombinimi i kësaj baze gjeologjike të qëndrueshme me teknikat e avancuara të minimi garanton që aktiviteti mineral të mos shkaktojë ndryshime negative në integritetin fizik të zonës së Seçishtës apo në sigurinë e vendbanimeve përreth.




Figura 5: Harta gjeologjike dhe pozita e lokacionit për shfrytëzim, Seçishtë, Hani i Elezit

3.4 Karakteristikat klimatike

Klima në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, dhe specifikisht në zonën e Seçishtës, përcaktohet nga pozita e saj gjeografike në skajin jugor të Kosovës. Kjo zonë shërben si një "portë" natyrore ku takohen rrymat ajrore kontinentale me ato mesdhetare. Karakteristikat kryesore klimatike janë:

- **Regjimi termik dhe ndikimet jugore**

Zona karakterizohet nga një klimë mesatare kontinentale, por me ndikime të ndjeshme të klimës mesdhetare që depërtojnë përmes luginës së Vardarit dhe grykës së Lepencit. Kjo

bën që temperaturat të jenë më të buta krahasuar me pjesët e tjera të Kosovës.

Temperatura mesatare vjetore në këtë rajon sillet rreth 11.87 °C. Muajt më të ftohtë janë janari dhe shkurti, ndërsa kulmi i nxehtësisë arrihet gjatë korrikut dhe gushtit. Një fenomen i veçantë është gjelbërimi i hershëm i vegjetacionit në këtë trevë, si pasojë e rrymave të ngrohta që vijnë nga jugu, gjë që dëshmon për një mikroklimë mjaft të favorshme.

- **Reshjet atmosferike dhe shpërndarja sazore**

Sasia vjetore e reshjeve luhetet në intervalin 300 mm deri në 600 mm. Shpërndarja e tyre nuk është e njëtrajtshme, gjë që ka rëndësi operative për minierën:

Maksimumi i reshjeve: Arrihet gjatë stinës së vjeshtës, ku vetëm në këtë periudhë regjistrohen rreth 300 mm reshje. Kjo kërkon që sistemet e drenazimit dhe pusët sedimentuese në gurore të jenë të projektuara për të përballuar prurje të larta ujore.

Minimumi i reshjeve: Gjatë muajve të verës (korrik dhe gusht), reshjet janë të pakta, rreth 130 mm. Kjo periudhë e thatë konsiderohet kritike për gjenerimin e pluhurit, andaj ndërmarrja duhet të rrisë intensitetin e spërkatjes së rrugëve me ujë gjatë këtyre muajve.

- **Lagështia dhe erërat**

Lagështia e ajrit është në nivele të moderuara, ndërsa konfiguracioni kodrinor-malor i terrenit ndikon në drejtimin e erërave. Gryka e Lepencit kanalizon lëvizjen e masave ajrore kryesisht në drejtimin Veri-Jug. Ky faktor është marrë parasysh gjatë modelimit të shpërndarjes së pluhurit teknologjik, duke siguruar që rrymat e ajrit të mos e bartin pluhurin drejt zonave të banuara, por ta shpërndajnë atë përgjatë zonave të pabanuara malore.

Këto kushte klimatike vlerësohen si të favorshme për zhvillimin e aktivitetit minerar gjatë gjithë vitit, me përjashtim të ditëve me reshje jashtëzakonisht të dendura, kur operimet mund të ndërpriten përkohësisht për arsye sigurie teknike.

3.5 Biodiversiteti dhe peizazhi

Biodiversiteti në zonën e Seçishtës karakterizohet nga një ekosistem kodrinor-malor me bimësi tipike të rajonit. Bazuar në vëzhgimet në terren, flora përbëhet kryesisht nga bimë të ulëta

barishtore, kaçuba dhe shkurre, si dhe drunj me rritje mesatare si shkoza, qarri dhe bungu. Nuk janë identifikuar specie bimore të rralla apo nën mbrojtje strikte, dhe sipërfaqja operationale nuk ka vlerë të lartë bujqësore apo kullimore.

Bota shtazore (fauna) përfshin lloje të zakonshme si lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi dhe zvarranikë të ndryshëm. Nga shpendët dallohen bilbilat, thëllënëza e fushës dhe shqiponja. Me fillimin e punimeve minerare, fauna pritet të largohet drejt habitateve fqinje pa pësuar dëmtim fizik, pasi zona nuk është korridor migrimi i mbrojtur.

Nga aspekti i peizazhit, eksploatimi do të shkaktojë një degradim vizual të përkohshëm për shkak të krijimit të shkallëve teknike. Megjithatë, projekti parashikon një plan rigoroz të rikultivimit teknik dhe biologjik. Pas përfundimit të operimeve, pamja natyrore do të rikthehet përmes mbjelljes së Pishës së zezë (*Pinus nigra*) dhe Pishës së bardhë (*Pinus silvestris*). Ky pyllëzim do të krijojë një ekosistem të ri që harmonizohet me peizazhin rrethues të maleve të Sharrit, duke shërbyer njëkohësisht si filtër natyror për ajrin.

3.6 Trashëgimia kulturore

Vlerësimi i ndikimit mjedisor për projektin e eksploatimit të gurit gëlqeror në lokalitetin “Seçishtë” ka trajtuar me kujdes raportin ndërmjet aktivitetit industrial dhe trashëgimisë kulturore të rajonit. Bazuar në hulumtimet e realizuara në bazat e të dhënave të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës dhe vëzhgimet direkte në terren, rezulton se:

Brenda perimetrit operacional të projektit (sipërfaqja prej 7.3 ha) nuk ekzistojnë objekte të mbrojtura të trashëgimisë arkitektonike, monumente historike apo pika me rëndësi arkeologjike të njohura paraprakisht. Lokacioni ndodhet në një zonë të lartë malore, e cila historikisht nuk ka shërbyer si zonë banimi apo aktiviteti që mund të linte gjurmë të rëndësishme kulturore.

Megjithatë, ndërmarrja “Esha Materials” SH.P.K. mbetet e obliguar që të zbatojë protokollin ligjor në rast të gjetjeve të rastësishme gjatë fazës së gërmimit të sterilit apo hapjes së rrugëve. Nëse gjatë punimeve hasen gjurmë të mundshme arkeologjike, do të aplikohen hapat e mëposhtëm:

Ndërpërja e punimeve: Aktivitetet në zonën e gjetjes do të ndalen menjëherë.

Njoftimi i autoriteteve: Do të njoftohet zyrtarisht brenda 24 orëve Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) dhe Ministria përgjegjëse për Kulturë.

Vlerësimi profesional: Punimet nuk do të rifillojnë pa marrë një pëlqim të ri zyrtar, pas vlerësimit të ekspertëve mbi rëndësinë e gjetjes.

Kjo masë siguron që zhvillimi i gurores të mos dëmtojë identitetin historik dhe kulturor të Komunës së Hanit të Elezit.

3.7 Demografia dhe karakteristikat socio-ekonomike

Projekti është në harmoni të plotë me **Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) të Hanit të Elezit 2025–2033**, i cili e trajton zonën e Seçishtës si një rajon me peshë të lartë industriale dhe nxjerrëse. Kjo siguron që operimi i ndërmarrjes "Esha Materials" të jetë i qëndrueshëm edhe në planifikimet afatgjata të komunës.

Analiza demografike është një komponent esencial i VNM-së, pasi përcakton raportin ndërmjet aktivitetit industrial dhe mirëqenies së popullatës lokale. Projekti i ndërmarrjes "Esha Materials" SH.P.K. zhvillohet në një rajon me karakteristika specifike sociale:

- Shtrirja dhe popullata: Komuna e Hanit të Elezit, ndonëse një nga komunat më të vogla në sipërfaqe në Kosovë (rreth 83 km²), ka një pozitë strategjike kufitare dhe një densitet të konsiderueshëm popullsie në zonat e banuara. Fshati Seçishtë, si zona e ndikimit të drejtpërdrejtë, karakterizohet nga një popullatë punëtore, e cila historikisht ka qenë e lidhur me resurset natyrore të zonës. Tradicionalisht, banorët merren me bujqësi, pemëtari dhe blegtori, por dekadat e fundit profili i tyre është shndërruar drejt sektorit industrial për shkak të pranisë së fabrikës së çimentos dhe guroreve tjera.
- Zona e ndikimit dhe vendbanimet: Një veçori pozitive demografike e këtij projekti është distanca prej mbi 800 metrash nga qendra e banuar e fshatit Seçishtë. Kjo distancë garanton që operimet minerare të mos kërkojnë zhvendosjen e asnjë familjeje dhe të mos cenojnë integritetin e zonave të banimit.
- Përfitimet socio-ekonomike dhe punësimi: Projekti pritet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në ekonominë lokale. Ndërmarrja "Esha Materials" është zotuar për punësimin prioritar të fuqisë punëtore vendase nga fshati Seçishtë dhe qendra e Hanit të Elezit. Punësimi në proceset e shpimit, transportit dhe mirëmbajtjes teknike do të ndihmojë në uljen e papunësisë dhe rritjen e standardit të jetesës. Për më tepër, ky projekt nxit zhvillimin e bizneseve ndihmëse lokale (furnitorët, shërbimet e mirëmbajtjes, logjistika), duke krijuar një zinxhir vlerash që mban kapitalin brenda komunës.

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISORË

4.1 Analiza e cilësisë aktuale të ajrit (gjendja zero)

Gjendja aktuale e cilësisë së ajrit në lokacionin specifik të projektit, në vendin e quajtur “Kodra” në Seçishtë, vlerësohet të jetë në një nivel mjaft të lartë pastërtie. Ky nivel i lakmueshëm i kualitetit të ajrit i atribuohet konfiguracionit natyror kodrinoro-malor dhe pranisë së florës e vegjetacionit rrethues, të cilët veprojnë si filtra biologjikë natyrorë. Për shkak të lartësisë mbidetare dhe qarkullimit të lirë të rrymave ajrore, aktualisht në këtë pikë nuk vërehen përqendrime të dëmshme të pluhurit apo gazeve ndotëse.

Megjithatë, kur analizohet regjioni më i gjerë i rrethinës, situata paraqitet më komplekse. Në zonat më të ulëta, veçanërisht në afërsi të fabrikës për prodhimin e çimentos dhe qendrës së Hanit të Elezit, ndotja e ajrit mundë të rritet si pasojë e aktivitetit të rëndë industrial. Një faktor tjetër kritik që ndikon negativisht në cilësinë rajonale të ajrit është frekuenca e madhe e automjeteve dhe transportit të rëndë në rrugën magjistrale Kaçanik–Shkup. Emetimet e gazeve shkarkuese nga trafiku dhe pluhuri që ngrihet nga lëvizja e mjeteve rrisin praninë e grimcave të suspenduara në atmosferë. Prandaj, ndonëse lokacioni i guores është aktualisht i pastër, ai ndodhet në një regjion që përballlet me sfida të vazhdueshme mjedisore sa i përket pastërtisë së ajrit.

4.2 Cilësia aktuale e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në lokacion

Gjendja hidrologjike në lokacionin e propozuar për eksploatim në Seçishtë karakterizohet nga mungesa e trupave ujqorë të qëndrueshëm brenda kufijve të parcelës operationale. Bazuar në hulumtimet në terren dhe karakteristikat gjeologjike të masivit gëlqeror, është konstatuar se brenda perimetrit prej 73,035 m² nuk ekzistojnë burime natyrale ujqorë, lumenj të përherëshëm apo akumulime liqenore. Regjimi ujqor në këtë pikë varet tërësisht nga të reshurat atmosferike, të cilat për shkak të pjerrtësisë së terrenit dhe disnivelit prej 105 metrash, nuk akumulohen në sipërfaqe por drenohen natyrshëm drejt zonave më të ulëta.

Në rrafshin rajonal, pika më e rëndësishme hidrografike është Lumi Lepenc, i cili rrjedh në një distancë prej rreth 1 km nga zona e projektit. Lokacioni i mihjes është pjesë e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi. Aktualisht, cilësia e ujit në lumin Lepenc vlerësohet si e rënduar, pasi ky recipient pranon ujëra të zeza të patrajtuara nga komunat përreth dhe shkarkime industriale. Përkundër kësaj

gjendjeje rajonale, ujërat që rrjedhin aktualisht nga ana e “Kodrës” së Seçishtës janë të pastra nga ndotja industriale, pasi zona nuk ka pasur aktivitet paraprak.

Rreziqet potenciale për ndotjen e ujërave gjatë fazës operacionale lidhen kryesisht me dy faktorë:

Ndotja nga sedimentet: Bartja e pluhurit teknologjik dhe grimcave të gurit përmes ujërave të shiut drejt përrenjve të përkohshëm që derdhen në Lepenc.

Rrjedhjet aksidentale: Potenciali për derdhje të karburanteve (naftës), vajrave hidraulikë apo lubrifikantëve nga makineritë e rënda dhe garnitura shpuese.

Për shkak të natyrës porozë të shkëmbinjve gëlqerorë (karstikë), ekziston edhe një rrezik teorik për infiltrimit e ndotësve në shtresat nëntokësore. Prandaj, ndonëse aktualisht gjendja e ujit në lokacion është neutrale, mbrojtja e lumit Lepenc si recipient final kërkon masa rigoroze parandaluese, siç janë pusët sedimentuese dhe separatorët e yndyrnave, për të siguruar që aktiviteti i ndërmarrjes “Esha Materials” të mos rëndojë më tej ekosistemin ujqor të rajonit.

4.3 Niveli ekzistues i zhurmës në sfond

Gjendja akustike në lokacionin e propozuar për mihje, në vendin e quajtur “Kodra” në Seçishtë, karakterizohet nga një ambient i qetë natyror, i cili është tipik për zonat malore të pashfrytëzuara industrialisht. Aktualisht, niveli i zhurmës në sfond (Gjendja Zero) vlerësohet të jetë brenda kufijve prej 35 deri në 45 dB, që korrespondon me standardet ndërkombëtare për zonat rurale ku dominon qetësia natyrore dhe mungesa e aktiviteteve njerëzore intensive.

Burimi i vetëm i ndjeshëm i zhurmës artificiale që depërton në këtë zonë vjen nga distanca, konkretisht nga rruga magjistrale Prishtinë–Shkup, e cila ndodhet rreth 3000 metra larg lokacionit. Edhe pse kjo rrugë ka një fluks të lartë të automjeteve dhe mjeteve të rënda transportuese, distanca e konsiderueshme dhe konfiguracioni kodrinor i terrenit shërbejnë si barrierë akustike natyrore, duke zbehur ndjeshëm intensitetin e zërit para se ai të arrijë në perimetrin e projektit.

Për më tepër, për shkak se objektet e banimit të fshatit Seçishtë ndodhen mbi 800 metra larg zonës operacionale, zhurma e përditshme urbane apo njerëzore është pothuajse e papërfillshme. Faktorët natyrorë, si rrymat e ajrit në grykën e Lepencit dhe fëshfëritja e vegjetacionit ekzistues, përbëjnë elementet kryesore të peizazhit zanor aktual. Ky nivel i ulët i zhurmës në sfond shërben si pikë referimi për vlerësimin e ndikimeve të ardhshme që do të sjellë përdorimi i makinerive të rënda (deri në 90 dB në burim) dhe procesi i minimit, duke u siguruar që ndikimi te banorët të mbetet brenda normave të lejuara ligjore (50 dB gjatë ditës).

4.4 Gjendja e tokës

Gjendja e tokës në lokacionin e propozuar për eksploatimin e gurit gëlqeror në Seçishtë pasqyron një mjedis natyror të paprekur nga aktivitetet industriale të mëparshme. Bazuar në hulumtimet pedologjike dhe vëzhgimet në terren, analiza e tokës mund të ndahet në disa pika kyçe:

- Përbërja dhe lloji i tokës: Toka në vendin e quajtur “Kodra” klasifikohet si tokë malore e pazhvilluara, e cila është formuar mbi bazamentin shkëmbor gëlqeror. Karakteristika kryesore e kësaj toke është trashësia e saj jashtëzakonisht e cekët, e cila sillet nga 0.25 m deri në maksimalisht 0.50 m. Ky profil pedologjik është tipik për zonat me pjerrtësi të lartë, ku proceset e alterimit të shkëmbit janë më të ngadalta se ato të drenazhimit natyror.
- Vetitë kimike dhe produktiviteti: Nga aspekti kimik, toka ka një natyrë bazike (alkaline) me një vlerë të pH që sillet rreth 8.0. Kjo është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e përbërjes karbonate të shkëmbit amë (gëlqerorit). Për sa i përket produktivitetit, toka nuk ka vlerë ekonomike për bujqësi intensive; ajo aktualisht shërben si tokë djerrinë, e mbuluar me bimësi barishtore të dobët dhe shkurre, duke e bërë atë të papërshtatshme për kultura bujqësore, por mjaftueshëm stabile për të mbajtur pyllëzimin me pisha.
- Pastërtia historike: Një faktor kritik për VNM-në është fakti se në këtë lokacion nuk ka ndotje historike të trashëguar. Meqenëse zona nuk ka pasur asnjëherë përdorim industrial, deponi mbeturinash apo aktivitete që përfshijnë substanca të rrezikshme, toka konsiderohet plotësisht e pastër. Ky fakt e bën shtresën humusore ekzistuese një resurs tejet të vlefshëm mjedisor, i cili do të gërmohet në mënyrë selektive dhe do të ruhet në pirgje të veçanta për t'u ripërdorur si substrat gjatë fazës finale të rikultivimit biologjik të shkallëve të mihjes.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1 Alternativa e zgjedhur (Lokacioni dhe teknologjia aktuale)

Pas vlerësimit të disa lokacioneve të mundshme në rajonin e Hanit të Elezit, ndërmarrja “Esha Materials” SH.P.K. ka përzgjedhur lokacionin në Seçishtë (vendi i quajtur “Kodra”) si variantin më optimal për zhvillimin e aktivitetit minerar. Kjo përzgjedhje bazohet në një analizë të detajuar të faktorëve teknikë dhe mjedisorë, të cilët e bëjnë këtë projekt të qëndrueshëm:

